<p>1.9. Dërgon/dorëzon njoftimet, faturat e tatimit në pronë, certifikatat e vlerës së vlerësuar dhe aktet e tjera zyrtare;</p> <p>1.10. Bashkëpunon dhe mbështet sektorët/zyrtarët e tjerë të Zyrës së Tatimit në Pronë; dhe</p> <p>1.11. Përbush çdo përgjegjësi/detyrë tjetër të zyrtarit/sectorit të funksioneve mbështetëse, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, apo të caktuar nga Menaxheri /Drejtori i Zyrës së Tatimit në Pronë .</p>	<p>1.9. Sends/Delivers notices, property tax bills, certificates of appraised value and other official acts;</p> <p>1.10. Cooperates and supports other officers/sectors of the Property Tax Office; and</p> <p>1.11. Fulfills any other responsibility/task of the (pertaining to the) supporting functions officer/sector, stipulated in the legislation in force on property tax, or assigned by the Property Tax Office Manager/Director</p>	<p>1.9. Šalje / podnosi obaveštenja, račune za porez na imovinu, sertifikate procenjene vrednosti i druge službene akte;</p> <p>1.10. Sarađuje i podržava druge sektore/ službenike Kancelarije za porez na imovinu, i</p> <p>1.11. Ispunjava sve druge odgovornosti / dužnosti službenika / sektora funkcija podrške, kako je utvrđeno u zakonodavstvu na snazi za porez na imovinu, ili ih dodeljuje menadžer / direktor Kancelarije za porez na imovinu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Sektor/Zyrtari i Kërkesave dhe Ankesave</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Requests and Complaints Sector/Officer</p>	<p style="text-align: center;">Član 9. Sektor/Službenik za zahteve i žalbe</p>
<p>1. Sektor/Zyrtari i kërkesave dhe ankesave ka përgjegjësitë e mëposhtme:</p> <p>1.1. Shqyrton kërkesat për shtyrjen e afatit për pagesën e detyrimeve tatimore në përputhje me nenin 24 të Ligjit dhe aktin përkatës nënligjor të nxjerrë për zbatimin e tij;</p>	<p>1. The requests and complaints sector/officer has the following responsibilities:</p> <p>1.1. Reviews requests for deferring the deadline for payment of tax liabilities in accordance with article 24 of the Law and the respective sub legal act issued for its implementation;</p>	<p>1. Sektor/Službenik za zahteve i žalbe ima sledeće odgovornosti:</p> <p>1.1. Razmatra zahteve za odlaganje roka za plaćanje poreskih obaveza u skladu sa članom 24. Zakona i relevantnim podzakonskim aktom izdatim za njegovo sprovođenje;</p>

<p>1.2. Shqyrton kërkesat për korrigjim në pajtim me aktin përkatës nënligjor për procedurat e ankimore;</p> <p>1.3. Shqyrton ankesat kundër faturës së tatimit në pronë dhe ankesat e tjera në pajtim me nenin 31 dhe 33 të Ligjit dhe aktin përkatës nënligjor për procedurat ankimore;</p> <p>1.4. Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me të gjitha autoritetet publike, personat juridikë ose organet që administrojnë ose kanë në dispozicion informacionin e nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesave për shtyrje dhe ankesave; dhe</p> <p>1.5. Përbush çdo përgjegjësi/detyrë tjetër të sektorit/zyrtarit të kërkesave dhe ankesave, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, apo të caktuar nga Menaxheri /Drejtori i Zyrës së Tatimit në Pronë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Sektori/Zyrtari i Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve</p>	<p>1.2. Reviews requests for correction in accordance with the respective sub – legal act on complaint procedures;</p> <p>1.3. Reviews complaints against the property tax bill and other complaints in accordance with article 31 and 33 of the Law and the respective sub – legal act on complaint procedures;</p> <p>1.4. Cooperates and exchanges information with all public authorities, legal persons or bodies that administer or have at their disposal the necessary information for the fair resolution of the requests for deferral and complaints; and</p> <p>1.5. Fulfills any other responsibility/task of the (pertaining to the) requests and complaints sector/officer, stipulated in the legislation in force on property tax, or assigned by the Property Tax Office Manager/Director.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Taxpayer Service and Education Sector/Officer</p>	<p>1.2. Razmatra zahteve za ispravke u skladu sa relevantnim podzakonskim aktom o žalbenim procedurama;</p> <p>1.3. Razmatra žalbe na račun poreza na imovinu i druge žalbe u skladu sa članovima 31 i 33. Zakona i relevantnim podzakonskim aktom o žalbenim procedurama;</p> <p>1.4. Saraduje i razmenjuje informacije sa svim javnim autoritetima, pravnim licima ili organima koji upravljaju ili imaju dostupne neophodne informacije za ispravno rešenje zahteva za odlaganje i žalbe; i</p> <p>1.5. Ispunjava sve druge odgovornosti / dužnosti sektora / službenika za zahteve i žalbe, kao što je utvrđeno u zakonodavstvu na snazi za porez na imovinu, ili ga dodeljuje menadžer / direktor Kancelarije za porez na imovinu.</p> <p style="text-align: center;">Član 10. Sektor/Službenik za usluge i edukaciju poreskih obveznika</p>
--	---	--

<p>1.Sektori/Zyrtari i shërbimit dhe edukimit të tatimpaguesve ka përgjegjësitë e mëposhtme:</p> <p>1.1. Asiston tatimpaguesit, debitorët, personat e interesuar ose përfaqësuesit e tyre në ushtrimin e të drejtave dhe/ose përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, përfshirë, por duke mos u kufizuar në:</p> <p>1.1.1.Plotësimin dhe paraqitjen e vetë - deklarimeve të ndryshme të kërkuara nga Ligji dhe aktet e tij nënligjore;</p> <p>1.1.2.Plotësimin dhe paraqitjen e ankesave;</p> <p>1.1.3.Plotësimin dhe paraqitjen e kërkesave për shtyrje të afatit për pagesë, kërkesave për rivlerësimin e pronës ose kërkesa të tjera; dhe</p> <p>1.1.4.Përdorimin e shërbimeve të ndryshme elektronike.</p> <p>1.2. Siguron që publiku merr informacion të saktë dhe në kohë përmes kanaleve të ndryshme;</p>	<p>1.The taxpayer service and education sector/officer has the following responsibilities:</p> <p>1.1.Assists taxpayers, debtors, interested persons or their representatives in exercising rights and/or fulfilling obligations stipulated in the legislation in force on property tax, including, but not limited to:</p> <p>1.1.1.Completion and submission of various self-declarations required by the Law and its sub – legal acts;</p> <p>1.1.2.Completion and submission of complaints;</p> <p>1.1.3.Completion and submission of requests for deferral of the deadline for payment, request for property reappraisal or other requests; and</p> <p>1.1.4.Use of various E – services.</p> <p>1.2. Assures that the public gets correct and timely information through different channels;</p>	<p>1.Sektor/Službenik za usluge i edukaciju poreskih obveznika ima sledeće odgovornosti:</p> <p>1.1.Pomaže poreskim obveznicima, dužnicima, zainteresovanim licima ili njihovim predstavnicima u ostvarivanju prava i / ili ispunjavanju obaveza utvrđenih u zakonodavstvu na snazi za porez na imovinu, uključujući, ali ne ograničavajući se na:</p> <p>1.1.1.Popunjavanje i podnošenje različitih samo-prijavlivanja koje zahteva Zakon i njegovi podzakonski akti;</p> <p>1.1.2.Popunjavanje i podnošenje žalbe;</p> <p>1.1.3.Popunjavanje i podnošenje zahteva za odlaganje roka plaćanja, zahteva za ponovnu procenu imovine ili drugih zahteva; i</p> <p>1.1.4.Korišćenje različitih elektronskih usluga.</p> <p>1.2. Osigurava da javnost dobija tačne i pravovremene informacije putem različitih kanala;</p>
--	--	--

<p>1.3. Sqaron tatimpaguesit, debitorët, personat e interesuar ose përfaqësuesit e tyre në lidhje me legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë dhe aktet e nxjerra gjatë zbatimit të tij;</p> <p>1.4. Informon publikun mbi legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë dhe mënyrën se si përdoren të hyrat nga tatimi në pronë në Komunë;</p> <p>1.5. Kryen fushata të ndryshme informuese dhe asiston Departamentin e Tatimit në Pronë në kryerjen e fushatave informuese,</p> <p>1.6. Shpall në ambientet e Komunës dhe publikon në faqen elektronike të Komunës njoftimin e kërkuar nga paragrafi 2 i nenit 22 të Ligjit;</p> <p>1.7. Siguron që çdo lloj informacioni shpallet ose publikohet në secilën prej gjuhëve zyrtare të Komunës, në të njëjtën shpallje/publikim dhe në të njëjtën mënyrë; dhe</p> <p>1.8. Përbush çdo përgjegjësi tjetër të sektorit/zyrtarit të shërbimit dhe edukimit të tatimpaguesve, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi të tatimit në pronë, apo të caktuar nga</p>	<p>1.3. Clarifies taxpayers, debtors, interested persons or their representatives on the legislation in force on property tax and acts issued during its implementation;</p> <p>1.4. Informs the public on the legislation in force on property tax and on how revenues from property tax are used in the Municipality;</p> <p>1.5. Carries out various information campaigns and assists the Property Tax Department in carrying out information campaigns;</p> <p>1.6. Announces in the premises of the Municipality and publishes on the Municipality website the notice required by paragraph 2 of article 22 of the Law;</p> <p>1.7. Assures that any kind of information is announced or published in each of the official languages of the Municipality, in the same announcement/publication and in the same manner; and</p> <p>1.8. Fulfills any other responsibility of the (pertaining to the) taxpayer service and education sector/officer, stipulated in the legislation in force on property</p>	<p>1.3. Informiše poreske obveznike, dužnike, zainteresovane strane ili njihove predstavnike u skladu sa zakonodavstvom na snazi za porez na imovinu i drugih akata izdatih tokom njegovog sprovođenja;</p> <p>1.4. Informiše javnost o zakonodavstvu na snazi za porez na imovinu i načinu kako se prihodit od poreza na imovinu koriste u opštini;</p> <p>1.5. Obavlja različite informativne kampanje i pomaže Odeljenju za porez na imovinu u sprovođenju informativnih kampanja,</p> <p>1.6. Najavljuje u prostorijama opštine i objavljuje na veb sajtu opštine obaveštenje koje zahteva stav 2. člana 22 Zakona;</p> <p>1.7. Osigurava da se bilo koja vrsta informacija objavljuje ili publicira na svakom od službenih jezika Opštine, u istom oglasu / publikaciji i na isti način; i</p> <p>1.8. Ispunjava sve druge odgovornosti sektora/ službenika usluga i edukacije poreskog obveznika, kako je utvrđeno u zakonodavstvu na snazi za porez na</p>
--	---	---

<p>Menaxheri /Drejtori i Zyrës së Tatimit në Pronë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Marrëdhëniet e Punës</p> <p>1.Marrëdhëniet e punës për zyrtarët e Zyrave të Tatimit në Pronë rregullohen sipas dispozitave të të legjislacionit në fuqi për shërbimin civil, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.</p> <p>2. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Zyrave të Tatimit në Pronë, që nuk kanë statusin e shërbyesit civil, rregullohen sipas dispozitave të Ligjit të Punës.</p>	<p>tax, or assigned by the Property Tax Office Manager/Director.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Labor Relations</p> <p>1.The labor relations for officers of Property Tax Offices are regulated according to the provisions of the legislation in force on civil service, unless otherwise stipulated by the law.</p> <p>2.The labor relations for employees of Property Tax Offices who do not have the status of civil servant are regulated through provisions of the Law on Labor.</p>	<p>imovinu, ili dodeljeno od menadžera/direktora za porez na imovinu.</p> <p style="text-align: center;">Član 11. Radni odnosi</p> <p>1.Radni odnosi za službenike Kancelarija za porez na imovinu regulisani su prema odredbama Zakona o civilnoj službi, osim ako je zakonom drugačije određeno.</p> <p>2.Radni odnosi za zaposlene u Kancelariji za porez na imovinu koji nemaju status civilnog službenika regulisani su u skladu sa odredbama Zakona o radu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Punësimi dhe Kategoritë e Pagave</p> <p>1. Zyrtari përgjegjës merr masat për respektimin e dispozitave të aplikueshme ligjore, për rekrutimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të zyrtarëve/nëpunësve në Zyrën e Tatimit në Pronë.</p> <p>2. Nivelet e pagave për çdo kategori, si dhe procedurat e kalimit nga një nivel më i ulët</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Employment and Salary Categories</p> <p>1.The responsible officer undertakes measures for respecting the applicable legal provisions on recruitment, parallel movement and promotion of officers/employees in the Property Tax Office.</p> <p>2.The salary levels for each category, as well as procedures on transferring from a lower level into a higher level of career</p>	<p style="text-align: center;">Član 12. Zapošljavanje i kategorije zarada</p> <p>1.Odgovorni službenik preduzima mere za poštovanje važećih zakonskih odredbi za zapošljavanje, paralelno kretanje i unapređenje službenika / zaposlenih u Kancelariji za porez na imovinu.</p> <p>2.Nivo plata za svaku kategoriju, kao i procedure prelaska sa nižeg nivoa na viši</p>

<p>në një nivel më të lartë karriere do të përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI III PARIMET E ADMINISTRIMIT TË TATIMIT NË PRONË DHE DISPOZITA ADMINISTRATIVE TË PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Parimet e Administrimit të Tatimit në Pronë</p> <p>1. Departamenti i Tatimit në Pronë dhe Zyrat e Tatimit në Pronë udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:</p> <p>1.1. Zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit;</p> <p>1.2. Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit që rregullon tatimin në pronë, nëpërmjet informimit, edukimit, asistimit dhe publikimit të akteve ligjore dhe nënligjore;</p> <p>1.3. Zhvillimi i strategjive dhe marrja e masave adekuate për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit që rregullon tatimin në pronë;</p>	<p>shall be defined based on the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER III PRINCIPLES OF PROPERTY TAX ADMINISTRATION AND GENERAL ADMINISTRATIVE PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 13 Principles of Property Tax Administration</p> <p>1. The Property Tax Department and the Property Tax Offices are led by the following principles:</p> <p>1.1. Equal and effective application of legislation;</p> <p>1.2. Encouragement of voluntary compliance with legislation that regulates property tax, through information, education, assistance and publication of legal and sublegal acts;</p> <p>1.3. Development of strategies and adequate measures to lower (mitigate) risks resulting from noncompliance with legislation regulating property tax;</p>	<p>nivo karijere određuje se u skladu sa važećim zakonodavstvom.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE III PRINCIPI UPRAVLJANJA POREZA NA IMOVINU I OPŠTE ADMINISTRATIVNE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 13. Principi upravljanja poreza na imovinu</p> <p>1. Odeljenje za porez na imovinu i Kancelarija za porez na imovinu rukovodi se sledećim principima:</p> <p>1.1. Primena istog i efikasnog zakonodavstva;</p> <p>1.2. Promovisanje dobrovoljnog poštovanja zakonodavstva koji regulišu porez na imovinu putem informisanja, edukacije, pomoći i objavljivanja zakonskih i podzakonskih akata;</p> <p>1.3. Razvijanje strategije i preduzimanje odgovarajućih mera za smanjenje rizika koji nastaju zbog nepoštovanja zakonodavstva koji reguliše porez na imovinu;</p>
--	---	--

<p>1.4. Bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha autoritetet publike, personat juridikë ose organet që kanë në administrim ose disponojnë informacionin e nevojshëm për administrimin e duhur të tatimit në pronë;</p> <p>1.5. Rregullimi dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të duhur;</p> <p>1.6. Promovimi i shërbimeve elektronike;</p> <p>1.7. Promovimi i transparencës; dhe</p> <p>1.8. Rekrutimi dhe promovimi i zyrtarëve të ndershëm, të drejtë dhe të aftë profesionalisht.</p>	<p>1.4. Close cooperation with all public authorities, legal persons or bodies that administer or have at their disposal the necessary information for the proper administration of property tax;</p> <p>1.5. Adjustment and adaption of systems of resource organization, information technology and business processes, on achieving appropriate efficiency and effectiveness;</p> <p>1.6. Promotion of electronic services;</p> <p>1.7. Promotion of transparency; and</p> <p>1.8. Recruitment and promotion of honest, fair and professionally capable officers.</p>	<p>1.4. Bliska saradnja sa svim javnim autoritetima, pravnim licima ili organima koji upravljaju ili poseduju potrebnim informacijama za pravilno upravljanje porezom na imovinu;</p> <p>1.5. Aranžiranje i prilagođavanje sistema organizacije resursa, informacione tehnologije i radnih procesa, za postizanje potrebne efikasnosti i efektivnosti;</p> <p>1.6. Promovisanje elektronskih usluga;</p> <p>1.7. Promovisanje transparentnosti; i</p> <p>1.8. Zapošljavanje i promocija poštenih, pravednih i stručno kvalifikovanih službenika.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Mënyrat e Komunikimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Ways of Communication</p>	<p style="text-align: center;">Član 14. Način komunikacije</p>
<p>1. Departamenti i Tatimit në Pronë ose Zyra e Tatimit në Pronë mund të kërkojë nga tatimpaguesi, debitori ose personi tjetër i interesuar, përdorimin e formave të</p>	<p>1. The Property Tax Department or the Property Tax Office may require from the taxpayer, debtor or other interested person to use the template forms on submitting information or requests/complaints.</p>	<p>1. Odeljenje za porez na imovinu ili Kancelarija za porez na imovinu može od poreskog obveznika, dužnika ili drugog zainteresovanog lica zahtevati korišćenje</p>

<p>veçanta, për paraqitjen e informacionit apo kërkesave/ankesave.</p> <p>2. Kur nuk kërkohet formë e veçantë, çdo komunikim, i kërkuar sipas legjislacionit që rregullon tatimin në pronë, paraqitet në mënyrë elektronike ose me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Konflikti i Interesit</p>	<p>2. When a specific form is not required, each communication required according to the legislation regulating property tax should be submitted electronically or in writing, unless otherwise stipulated.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Conflict of Interest</p>	<p>posebnih obrazaca za podnošenje informacija ili zahteva / žalbi.</p> <p>2. Kada nije potreban poseban obrazac, svaka komunikacija koja se zahteva prema zakonodavstvu koji uređuje porez na imovinu podnosi se elektronski ili pismeno, osim ako je drugačije predviđeno.</p> <p style="text-align: center;">Član 15. Konflikt interesa</p>
<p>Zyrtarët e Zyrës së Tatimit në Pronë zbatojnë, në mënyrë të drejtë e të paanshme, legjislacionin në fuqi, si dhe raportojnë paraprakisht rastet e konfliktit të interesit në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Informacioni mbi Legjislacionin</p> <p>1. Departamenti i Tatimit në Pronë informon publikun për përmbajtjen, rolin dhe rëndësinë e legjislacionit të tatimit në pronë, duke përdorur mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë median e shkruar dhe atë elektronike.</p>	<p>The Property Tax Department or the Property Tax Office officers implement, in a fair and impartial manner, the legislation in force, as well as report in advance cases of conflict of interest in compliance with the provisions of the legislation in force on prevention of conflict of interest in discharge of public function.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Information on Legislation</p> <p>1. The Property Tax Department informs the public on the content, role and importance of property tax legislation, by using different means of communication, including written and electronic media.</p>	<p>Službenici Kancelarije za porez na imovinu sprovode pravično i nepristrasno zakonodavstvo na snazi, kao i prijavljuju slučajeve konflikta interesa u skladu sa odredbama Zakona o sprečavanju konflikta interesa u ostvarivanju javne funkcije.</p> <p style="text-align: center;">Član 16. Informacije o zakonodavstvu</p> <p>1. Odeljenje za porez na imovinu informiše javnost o sadržaju, ulozi i značaju zakonodavstva o porezu na imovinu, koristeći različita sredstva komunikacije, uključujući pisane i elektronske medije.</p>

<p>2. Departamenti i Tatimit në Pronë publikon në një faqe elektronike në dispozicion të publikut:</p> <p>2.1. Ligjin dhe aktet nënligjore mbi tatimin në pronë;</p> <p>2.2. Vendimet e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese, për raste që kanë të bëjnë me tatimin në pronë;</p> <p>2.3. Opinionet ligjore të nxjerra në përputhje me nën paragrafin 2.2.9 të nenit 13 të Ligjit; dhe</p> <p>2.4. Materiale sqaruese dhe komentare të legjislacionit të tatimit në pronë.</p>	<p>2.The Property Tax Department publishes on a publicly available website:</p> <p>2.1. Laws and sub-legal acts on property tax;</p> <p>2.2. Decisions of the Supreme Court and Constitutional Court, on property tax related cases;</p> <p>2.3. Legal opinions issued in conformity with paragraph 2.2.9 of article 13 of the Law; and</p> <p>2.4. Clarifying materials and commentaries of property tax legislation</p>	<p>2.Odeljenje za porez na imovinu objavljuje na elektronskom sajtu dostupnom javnosti:</p> <p>2.1.Zakon i podzakonske akte o porezu na imovinu;</p> <p>2.2. Odluke Vrhovnog suda i Ustavnog suda, o slučajevima koji se odnose na porez na imovinu;</p> <p>2.3. Pravna mišljenja izdata u skladu sa stavom 2.2.9 člana 13. Zakona o porezu na nepokretnu imovinu; i</p> <p>2.4. Objašnjavajuće materijale i komentare zakonodavstva za porez na imovinu.</p>
<p style="text-align:center">KAPITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE</p> <p style="text-align:center">Neni 17 Ristrukturimi</p>	<p style="text-align:center">CHAPTER IV FINAL PROVISIONS</p> <p style="text-align:center">Article 17 Restructuring</p>	<p style="text-align:center">POGLAVLJE IV ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p style="text-align:center">Član 17</p>
<p>Komunat rristrukturojnë strukturat aktuale organizative të Zyrrave të Tatimit në Pronë sipas dispozitave të këtij Udhëzimi Administrativ brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.</p>	<p>Municipalities shall restructure the current organizational structures of Property Tax Offices according to provisions of this Administrative Instruction within six (6) months from the day of its entry into force.</p>	<p>Restrukturirane Opštine rristrukturiraju sadašnju organizacionu strukturu Kancelarije za porez na imovinu u skladu sa odredbama ovog Administrativnog uputstva u roku od šest (6) meseci od dana njegovog stupanja na snagu.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 18 Shfuqizimi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ shfuqizon Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2011 për organizmin dhe funksionimin e zyrave komunale të tatimit në pronë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 19 Hyrja në Fuqi</p> <p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë kalendarike pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p style="text-align: center;">Ministër i Financave</p> <p style="text-align: center;">Datë: ___/___/_____</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Repeal</p> <p>This Administrative Instruction repeals Administrative Instruction No. 10/2011 for organization and functioning of municipal property tax offices.</p> <p style="text-align: center;">Article 19 Entry into Force</p> <p>This Administrative Instruction shall enter into force seven (7) calendar days after its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p style="text-align: center;">Minister of Finance</p> <p style="text-align: center;">Date: ___/___/_____</p>	<p style="text-align: center;">Član 18. Ukidanje</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo ukida Administrativno uputstvo br. 10/2011 o organizaciji i funkcionisanju Opštinskih kancelarija za porez na imovinu.</p> <p style="text-align: center;">Član 19. Stupanje na snagu</p> <p>Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) kalendarskih dana nakon objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Bedri Hamza</p> <p style="text-align: center;">_____</p> <p style="text-align: center;">Ministar finansija</p> <p style="text-align: center;">Datum: ___/___/_____</p>
--	---	---

**PROJEKT UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR ORGANIZMIN E ZYRAVE TË TATIMIT NË PRONË DHE PARIMET E
ADMINISTRIMIT TË TATIMIT NË PRONË**

**DRAFT ADMINISTRATIVE INSTRUCTION ON ORGANIZATION OF PROPERTY TAX OFFICES
AND PRINCIPLES OF PROPERTY TAX ADMINISTRATION**

**NACRT ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO O ORGANIZACIJI KANCELARIJA ZA POREZ NA
IMOVINU I PRINCIPIMA UPRAVLJANJA POREZA NA IMOVINU**